

| Emri i Lëndës : Hyrje në Financë |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
|----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                             | Tipi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| EMS 115                          | B                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Vjeshtë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 3.00                | 1.00                | 0.00           | 3.50    | 5.00 |
|                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Kriselda Gura, MSc                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Anglisht                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Bachelor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Qëllimi i kësaj lënde është të sigurojë një hyrje gjithëpërfshirëse të parimeve themelore të financës, duke vënë theksin tek financat e korporatave. Konceptet e studiuar në këtë lëndë do të shërbejnë si bazë për kurset e tjera si investimet dhe financat e korporatave. Fokusi i kësaj lënde janë tregjet financiare dhe mjetet dhe njohuritë të cilat nevojiten për të kuptuar sesi këto tregje funksionojnë. Roli që kanë financat dhe sistemi financiar (përfshirë bankat, njërmjetësit e tjerë financiarë dhe bankën qendrore) në ekonominë e vendit do të diskutohet po ashtu në mënyrë integrale përgjatë lëndës. Investimet janë një tjetër disiplinë e rëndësishme, e cila do të diskutohet. Kursimet, normat e interes dhe llogaritë rrjedhëse të fondeve janë po ashtu tema të rëndësishme që preken gjatë lëndës. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Objekti i kësaj lende është të ofrojë një prezantim gjithëpërfshirës të parimeve themelore të financës, me theks në temat në fushën e financave të korporatave. Konceptet e zhvilluara në këtë kurs formojnë bazën për të gjitha kurset e njëpasnjëshme të financave, të tilla si investimet dhe financat e korporatave. Pas kursit, studentët pritet që: (1) të konsolidojnë konceptet themelore të financës të përfshira në kurs për t'u përgatitur për studimin e mëtejshëm në financë; (2) zhvillojnë aftësinë për zgjidhjen e problemeve me filozofinë e financës në mënyrë që ata të mund të trajtojnë problemet financiare në një mjedis të ri me mjetet dhe teknikat e mësuara nga kursi.                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | -norma e interesit -obligacione dhe tituj pronësie -flukset rrjedhëse -tregje financiare -vlera në kohë e parasë -risku -kthimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| Java                             | Tema                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| 1                                | Prezantim Silabusi Prezantim me Lëndën, Mënyrën e Vlerësimit dhe Tekstin respektiv                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
| 2                                | Kapitulli 1- Hyrje në financë Ky kapitull synon të qartësojë objektivat e një firme dhe të përshkruaj rolin e financës në një biznes; të bëjë një ndarje midis formave ligjore të firmave dhe të shpjegojë parimet bazë të financës, rëndësinë e tyre dhe rëndësinë e etikës dhe bësimit. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financiar, Edicioni i 9-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2017. Kapitulli I. Faqe 26- 45.)                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                     |                     |                |         |      |
